



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 824 Prot.

Patos, më 13 / 03 / 2025

PROJEKTVENDIM

Nr 15 Datë 13 / 03 / 2025

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VENDIMARRJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PATOS PËR VITIN 2024

Mbështetur në piken 3 të nenit 15 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 4 neni 120, *Vlerësimi i Performancës dhe Llogaridhënia e Këshillit dhe Sekretariatit*” i rregullores “Për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Bashkisë Patos”, V.K.B nr. 84 datë 27.11.2024 për miratimin e planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak Patos për vitin 2025 po ju prezantojmë Raportin e vendimarrjes së Këshillit Bashkiak Patos për vitin 2024:

Ky raport përmban informacion për:

- Numrin total të mbledhjeve.
- Numrin total të mbledhjeve online.
- Numrin e mbledhjeve në sallë.
- Numrin e akteve të miratuara nga këshilli gjatë vitit 2024.
- Numrin e projektvendimeve të kthyera nga këshilli gjatë vitit 2024.
- Informacion të përmbledhur mbi zbatimin e vendimeve nga administrata.
- Numrin e vendimeve të kthyera nga Prefektura.
- Llojet e vendimeve sipas tematikave të tyre.

Referuar sa më sipër Këshilli i Bashkisë gjatë vitit 2024.

- Numri total i mbledhjeve të miratuara gjatë vitit 2024 është 96. Nga këto vendime vetëm 20 kanë qënë me karakter normativ dhe 4 vendime nuk kanë qënë me karakter normativ por ligjshmëria e tyre është verifikuar nga Prefekti i Qakut për shkak të parashikimit ligjor, ndërsa pjesa tjetër ka qënë me karakter individual dhe kolektiv.

Vendimet me karakter normativ i janë dërguar Prefekturës së Qarkut Fier

për konfirmim ligjor për të cilat është konfirmuar ligjshmëria ndërsa për një vendim ka ardhur përgjigja se nuk është në përputhje me ligjin, konkretisht vendimi nr. 23 datë 29.03.2024 i cili është shfuqizuar me vendimin nr. 40 datë 30.04.2024.

- Mbledhje të zhvilluara online nuk ka.
- Numri i mbledhjeve të zhvilluara në sallë është 17 të cilat kanë qënë të hapura për publikun. Nga mbledhjet e zhvilluara 13 kanë qënë mbledhje të radhës dhe 4 jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë. Një pjesë të mbledhjeve janë zhvilluar live në faqen e facebook të Këshillit ndërsa pjesa tjetër është e regjistruar me video-audio. Njoftimi i mbledhjeve dhe publikimi është bërë sipas kritereve që përcakton ligji.
- Nuk ka projektvendimeve të kthyer nga këshilli gjatë vitit 2024.
- Zbatimi i vendimeve nga administrata. Pas zbardhjes së vendimeve ato i kalojnë ekzekutivit për zbatim si dhe në çdo mbledhje pasardhëse është raportuar gjithmonë në lidhje me zbatueshmërinë e tyre. Në pikën e tretë të rendit të ditës është dhënë informacion mbi vendimet e marra nga këshilli, si dhe konfirmimet e tyre nga Prefektura.
- Vetëm një vendim është kthyer nga Prefektura ku ka ardhur përgjigja se nuk është në përputhje me ligjin i cili është shfuqizuar në mbledhjen e radhës.
- Llojet e vendimeve sipas tematikave të tyre.

Vendime për çështje financiare /tatime/buxheti/ nivel pagash 23

Vendime për çështje projktesh infrastrukturore 1

Vendime për çështje urbane dhe pronash 2

Vendime për çështje sociale, ndihmë ekonomike 37

Vendime për çështje arsimit , bursa 4

Vendime për çështje të ndryshme 29

Njoftimi për rendin e ditës si dhe përmbajtja e projektakteve janë publikuar në web si dhe në profilin zyrtar të rrjetëve sociale të këshillit. Të gjitha vendimet pas zbardhjes së tyre janë dërguar platformës Vendime.al e cila është e ndërlidhur dhe me web-in e këshillit. Gjithashtu gjatë vitit 2024 këshilli ka realizuar mbledhje të cilat janë transmetuar live në facebook.

Albiona Lamaj
Zv/ Kryetare

Enkelejda Ajazi
Kryetar Grupi

Eduart Faslliaj
Zv/ Kryetar

Artan Velçani
Kryetar Grupi



Adresa: Lagja "Nafëtar" Rruga "Unaza", Patos